



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 144

Tiranë – E premte, 7 gusht 2015

## PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 81/2015 datë 23.7.2015	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për kontrollin e lëndëve narkotike dhe zbatimin e ligjit..... 10775
Ligj nr. 82/2015 datë 23.7.2015	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar 2011, për projektin “Program për sektorin e ujit/program për furnizimin e zonave rurale me ujë, III”..... 10781
Ligj nr. 83/2015 datë 23.7.2015	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar 2011, për masën shoqëruese të projektit “Program për sektorin e ujit/program për furnizimin e zonave rurale me ujë, III”..... 10783
Ligj nr. 84/2015 datë 23.7.2015	Për ratifikimin e marrëveshjes së garancisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe KfW Frankfurt am Main, në lidhje me marrëveshjen e huas, në shumën 40 milionë euro, ndërmjet Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a. (OST), dhe KfW, në mbështetje të projektit “Eficienca energjetike – programi për sektorin e transmetimit të energjisë elektrike”..... 10785
Ligj nr. 86/2015 datë 23.7.2015	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar 2010, për projektin “Rifinancimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në zonat urbane dhe rurale, faza e dytë”..... 10789

Ligj nr. 87/2015 datë 23.7.2015	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar 2009, për projektin “Energjia ujore dhe siguria e digave në kaskadën e Drinit”.....	10791
Ligj nr. 88/2015 datë 23.7.2015	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar 2011, për projektin “Eficiencia energjetike - programi për sektorin e transmetimit të energjisë elektrike”...	10792
Ligj nr. 89/2015 datë 23.7.2015	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar 2010, për projektin “Eficiencia energjetike përmes sektorit bankar”.....	10794
Ligj nr. 90/2015 datë 23.7.2015	Për një ndryshim në ligjin nr.92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.....	10796
Ligj nr. 91/2015 datë 23.7.2015	Për një shtesë dhe ndryshim në ligjin nr.9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.....	10796
Ligj nr. 92/2015 datë 23.7.2015	Për disa shtesa në ligjin nr.22/2014 “Për dhënie amnistie”.....	10797
Vendim i Kuvendit nr. 82/2015, datë 23.7.2015	Për caktimin e masës së shpërblimit mujor fiks të anëtarit të Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar.....	10797
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 697, datë 6.8.2015	Për dhënien e ndihmës financiare, nga qeveria shqiptare për qeverinë e Republikës së Maqedonisë, për lehtësimin e pasojave të dëmeve të shkaktuara nga përmytjet në gusht 2015, në Tetovë.....	10798



**LIGJ**  
**Nr. 81/2015**

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES  
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS  
SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË  
SHTETEVE TË BASHKUARA TË  
AMERIKËS PËR KONTROLLIN E  
LËNDËVE NARKOTIKE DHE ZBATIMIN  
E LIGJIT**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**Neni 1**

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për kontrollin e lëndëve narkotike dhe zbatimin e ligjit, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji dhe pjesëve përbërëse të tij.

**Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 23.7.2015

**Shpallur me dekretin nr. 9193, datë 30.7.2015  
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bujar Nishani**

**MARRËVESHJE**

**MBI KONTROLLIN E LËNDËVE  
NARKOTIKE DHE ZBATIMIN E LIGJIT  
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË  
SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË  
SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS**

**I. TË PËRGJITHSHME**

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (në tekstin më poshtë, secili individualisht i referuar si “Palë” dhe bashkërisht si “Palët”) bien dakord për të krijuar dhe për të mbështetur një projekt të planifikuar për të forcuar sektorin e drejtësisë shqiptare dhe kapacitetin e saj për të hetuar, për të ndjekur penalisht dhe për të gjykuar krimin, veçanërisht krimin e organizuar dhe korrupsionin, duke dhënë

garanci për një proces të rregullt dhe standarde ligjore ndërkombëtare; nxitur zhvillimin profesional të zyrtarëve të sektorit të drejtësisë; për të siguruar ndihmë teknike në lidhje me reformat e duhura legislative dhe përpjekjet për zhvillim të politikave.

Masat që duhen ndërmarrë dhe burimet që do të ofrohen nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Qeveria e Republikës së Shqipërisë (QSH) në mbështetje të kësaj Marrëveshjeje (M) janë përcaktuar më poshtë dhe përbëjnë premtime të fuqishme nga secila Palë. Fondet e dhëna nga Qeveria e SHBA-së sipas kushteve të kësaj PM-je, në total \$7,778,000\$. Sigurimi i fondeve të Qeverisë amerikane pas vitit fiskal aktual kushtëzohet me përparimin e kënaqshëm drejt qëllimeve të projektit dhe disponueshmërinë e fondeve të autorizuara nga viti në vit nga ana e Kongresit amerikan dhe të miratuar nga Departamenti Amerikan i Shtetit. Palët bien dakord që fondet shtesë mund të jepen për këto qëllime në bazë të të njëjtëve termave dhe kushteve që përcaktohen në marrëveshje, të ndryshuara, pa pasur nevojë të mëtejshme për të ndryshuar marrëveshjen për të pasqyruar shumën e fondeve të siguruar. Qeveria e SHBA-së do të njoftojë Qeverinë e Republikës së Shqipërisë kur burime të tjera do të jepen në mbështetjen të këtyre projekteve.

**II. PËRSHKRIMI I PROJEKTTIT**

Asistenca do të zbatohet nën kujdesin e dyja projekteve të Departamentit të Shtetit, Byrosë së Çështjeve Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Zbatimit të Ligjit: Zhvillimi i Sektorit të Drejtësisë Penale dhe Zhvillimi i Zbatimit të Ligjit. Të dy projektet janë projektuar për të përmirësuar aftësinë e qeverisë shqiptare për të penguar dhe për t'u përgjigjur për të gjitha llojet e krimit, me fokus të veçantë në përmirësimin e efikasitetit dhe të cilësisë së procedimeve penale, zhvillimin e kapaciteteve të institucioneve shqiptare përgjegjëse për luftën kundër krimit, përmirësimin e sistemit dhe cilësinë e trajnimit të profesionistëve shqiptarë të përfshirë në procesin e luftës kundër krimit dhe rritjen e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë penale. Drejt këtij qëllimi, Qeveria e SHBA-së dhe Qeveria e Republikës së Shqipërisë do të ndërmarrin veprime dhe do të angazhojnë burime me bazë vjetore, siç autorizohen nga proceset e tyre përkatëse legislative për të mbështetur këtë përpjekje.



Programi i Zhvillimit të Sektorit të Drejtësisë Penale

Programi i Zhvillimit të Sektorit të Drejtësisë Penale do t'u ofrojë ndihmë institucioneve shqiptare kyçe të drejtësisë penale, zyrtarëve të antikorrupsionit dhe agjencive mbështetëse për të rritur kapacitetin e Shqipërisë, për të luftuar të gjitha format e krimit, veçanërisht duke u fokusuar në përmirësimin e efikasitetit dhe të cilësinë e procedimeve penale, si dhe forcimin institucional dhe zhvillimin në këtë drejtim. Kontributet e projektit do të përfshijnë trajnimin, donacionet e pajisjeve, asistencën teknike, dhe këshillat nga ekspertë të fushave. Masat që duhen ndërmarrë në mbështetje të kësaj nisme përfshijnë zbatimin e 3 (tre) komponentëve: 1) rritjen e kapaciteteve të prokurorëve dhe hetuesve për të luftuar krimin e organizuar, korrupsionin, dhe forma të tjera të veprimtarisë kriminale; 2) zhvillimin e Sistemit të Drejtësisë Penale përmes legjislacionit të përmirësuar; 3) të ndihmojë gjyqësorin për të gjykuar çështjet në kohën e duhur, në mënyrë efektive, të paanshme dhe etike; dhe 4) rritjen e aksesit të qytetarëve të drejtësia.

Programi i zhvillimit të Sektorit të Drejtësisë Penale do të marrë plotësisht në konsideratë negociatat e anëtarësimit ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, veçanërisht Planet e Veprimit të qeverisë shqiptare për kapitujt: 23 (Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore) dhe 24 (Drejtësia, Liria dhe Siguria) të *Acquis Communautaire*. Për më tepër, Programi i zhvillimit të Sektorit të Drejtësisë Penale do të ofrojë personalisht ekspertizë sa herë që është e përshtatshme dhe e mundshme.

Projekti për Zhvillimin e Zbatimit të Ligjit

Projekti i Zhvillimit të Zbatimit të Ligjit do të japë asistencë për zbatimin e ligjeve të Shqipërisë për të rritur kapacitetet e Shqipërisë për të penguar, për të zbuluar dhe për të hetuar të gjitha format e krimit, veçanërisht duke u përqendruar në përmirësimin e efikasitetit dhe të cilësisë së procedimeve penale. Projekti i Zhvillimit të Zbatimit të Ligjit do të përbëhet nga një ish-ekspert i zbatimit të ligjit me përvojë dhe stafi mbështetës. Rezultatet e projektit do të përfshijnë trajnimin, donacionet e pajisjeve, asistencë teknike dhe këshilla nga ekspertë të fushave.

Masat që duhet të ndërmerren në mbështetje të kësaj nisme përfshijnë zbatimin e 3 (tre) komponentëve: 1) Zhvillimin e Drejtimit Strategjik

të Zbatimit të Ligjit; 2) Zhvillimin e Zbatimit Operativ të Ligjit; dhe 3) Komponentin e Zhvillimit të Llogaridhënies Policore.

Masat që do të merren nga Qeveria e SHBA-së, përfshijnë:

- Mbështetjen dhe financimin e projekteve të Zhvillimit të Sektorit të Drejtësisë Penale dhe të projekteve të Zhvillimit të Zbatimit të Ligjit për zbatimin e komponentëve të përshkruar më sipër.

Masat që do të merren nga QSH-ja përfshijnë:

- Të sigurojë vende për trajnime sa herë që të jetë e mundur dhe të caktojë pikat e kontaktit për koordinimin e të gjitha aktiviteteve;

- Sigurimi i zbatuesve të programeve me qasje të zyrtarët e duhur dhe të pajisjet e dhuruara më parë, në mënyrë që të japin ndihmën e përshkruar më sipër dhe për të kryer monitorimin e përdorimit në destinacion;

- Të caktojë kandidatët e përshtatshëm dhe të kualifikuar për t'u trajnuar, të cilët kanë nivelin e angazhimit dhe të kompetencës për të shfrytëzuar trajnimin dhe ndihma të tjera në mënyrë efektive;

- Vendosja e sistemeve dhe procedurave për të siguruar që institucionet dhe individët që marrin trajnim, pajisje dhe ndihmë tjetër të shfrytëzojnë plotësisht ndihmën e marrë në interes të QSH-së, përfshirë kërkesat që personat, që marrin trajnim në fusha të specializuara të shërbejnë në pozicionet që i lejojnë të shfrytëzojnë dhe të ndajnë aftësitë dhe njohuritë e marra në emër të Qeverisë Shqiptare për një periudhë kohore proporcionale me fushëveprimin, kompleksitetin dhe kohëzgjatjen e trajnimit të marrë;

- Puna me zbatuesit e programeve për identifikimin e rezultateve nga çdo vizitë studimore ndërkombëtare;

- Hartimi i një strategjie tranzicioni që përfshin drejtimin shqiptar të këtyre aktiviteteve, si dhe të pajisjeve të dhuruara, duke siguruar që trajnimet nga Qeveria e SHBA-së dhe ndihma teknike të përfshihen si pjesë e zbatimit nga ana e QSH-së.

Palët mund të rrisin, ndryshojnë ose ndërpresin projektet e ndërmarra në lidhje me këtë Marrëveshje, siç është rënë dakord nga Palët me shkrim. Një projekt i tillë do t'u nënshtrohet termave dhe kushteve të kësaj Marrëveshje.

### III. QËLLIMET E ZBATIMIT DHE MATJA E EFEKTIVITETIT

Qëllimi afatgjatë i projekteve të financuara nga Qeveria e SHBA-së në Shqipëri është forcimi i



sektorit shqiptar të drejtësisë penale, institucioneve dhe zyrtarëve të tij, në mënyrë që të përgjigjet ndaj të gjitha llojeve të krimit, me theks të veçantë të korrupsioni dhe krimi i organizuar, me qëllim që të sjellë vendin më pranë anëtarësimit në Bashkimin Evropian, në përputhje me qasjen strategjike të vendit. Plani i Kontrollit të Zbatimit (PKZ), gjithashtu, i referuar si një Plan Mbikëqyrjeje dhe Vlerësimi (M & V) për kontrollin e procesit të mbledhjes së të dhënave, si dhe mbledhjen e rregullt të të dhënave, do të zbatohet për çdo projekt;

Programi i Zhvillimit të Sektorit të Drejtësisë Penale

Komponenti i projektit 1: Rritja e kapaciteteve të prokurorëve dhe hetuesve për të luftuar krimin e organizuar, korrupsionin dhe format e tjera të veprimtarisë kriminale

- Objektivi i këtij komponenti të projektit është që të zhvillojë një trajnim, si dhe qasje gjithëpërfshirëse kundrejt dhënies së përvojës dhe këshillimit për prokurorët dhe hetuesit.

Komponenti i projektit 2: Zhvillimi i Sistemit të Drejtësisë Penale nëpërmjet legjislacionit të përmirësuar

- Objektivi i këtij komponenti të projektit është që të sigurojë kontribute dhe këshilla për hartimin e ligjeve të rëndësishme të drejtësisë penale, politikat dhe kodet etike.

Komponenti i projektit 3: Ndihmon gjyqësorin për të gjykuar çështjet në kohën e duhur, në mënyrë efikase, të paanshme dhe etike

- Objektivi i këtij komponenti të projektit është rritja e transparencës dhe e kuptimit të përgjegjësisë dhe të llogaridhënies gjyqësore.

Komponenti i projektit 4: Rritja e qasjes së qytetarëve të drejtësisë

- Objektivi i këtij komponenti të projektit është rritja e qasjes në drejtësi e qytetarëve të Shqipërisë.

Metodat e verifikimit të arritjeve të projektit përfshijnë vrojtimin nga ana e personelit të dy qeverive bashkëpunuese, dhe analizat e të dhënave përkatëse zyrtare, siç janë të dhënat mbi asetet e konfiskuara përkohësisht dhe në mënyrë të përhershme, të dhënat mbi dënimet për krime të veçanta dhe të tjera.

Projekti për Zhvillimin e Zbatimit të Ligjit

Komponenti i projektit 1: Zhvillimi i drejtimit strategjik

- Objektivi i këtij komponenti të projektit është

forcimi i udhëheqjes, drejtimit dhe profesionalizmit të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Personelit të Drejtimit Ekzekutiv të Policisë së Shtetit.

Komponenti i Projektit 2: Zhvillimi i Zbatimit Operativ të Ligjit

- Objektivi i këtij komponenti të projektit është përmirësimi i aftësive operative të Policisë së Shtetit dhe agjencive të tjera të zbatimit të ligjit, sidomos të atyre që lidhen me aftësitë bazë policore, kundër trafikut të lëndëve narkotike dhe të terrorizmit.

Komponenti 3 i Projektit: Komponenti i Zhvillimit të Llogaridhënies së Policisë

- Objektivi i këtij komponenti të projektit është të zhvillojë një mbikëqyrje të pavarur civile të Policisë së Shtetit.

#### IV. VLERËSIMI PROGRAMIT

Përfaqësuesit e palëve do të takohen dy herë në vit për të rishikuar ecurinë drejt arritjes së qëllimeve të projektit. Një raport me shkrim i këtyre takimeve do të përgatitet dhe do të sigurohet për palët përkatëse. Ecuria do të vlerësohet në pajtim me matjet e arritjeve të përshkruara më sipër. Informacioni që duhet të merret parasysh në kryerjen e këtyre vlerësimeve do të përfshijë tregues cilësorë dhe sasiorë. Këto vlerësime kryhen veç nga mbikëqyrja e vazhdueshme e programeve dhe aktiviteteve të kryera nga personeli përkatës i të dyja qeverive.

Në këtë kuadër, puna praktike e përfituesve do të ndiqet në mënyrë që të nxirren në pah ndryshimet që lidhen potencialisht me përvetësimin e aftësive dhe njohurive (për shembull, zbatimin e standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe fusha të tjera, koha e nevojshme për kryerjen e hetimeve, numri e padive të depozituara dhe të gjykuara, dhe arritje të ngjashme të gjurmueshme).

#### DISPOZITAT TË PËRGJITHSHME

##### 1. Fondet

A. Derdhja e fondeve të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara do të bëhet për prokurimin e pronës, pajisjeve, furnizimeve, materialeve (të referuara më poshtë bashkërisht si “pronë”) dhe shërbimet.

B. Fondet e angazhuara nga Qeveria Shteteve të Bashkuara, të cilat nuk janë shpenzuar brenda dymbëdhjetë muajve pas mbylljes së vitit financiar të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara, në të cilin është nënshkruar Marrëveshja, mund të mos angazhohen më nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara. Një zgjatje e kësaj periudhe mund të



lejohej nga Byroja e Çështjeve Ndërkombëtare për Lëndët Narkotike dhe Zbatimin e Ligjit.

C. Qeveria e Republikës së Shqipërisë do të kontribuojë në projektin/et në Marrëveshje duke siguruar fonde të mjaftueshme për shpenzimet normale administrative dhe shpenzime të ngjashme për personelin shqiptar. Këto shpenzime përfshijnë pagesën e qirave dhe shërbimeve komunale, shpenzimet telefonike, pagat dhe përfitimet (duke përfshirë sigurimet shëndetësore dhe të tjera), dietat dhe shpenzimet e udhëtimit brenda Shqipërisë, pajisjet personale dhe uniformat, dhe rekrutimin e mbajtjen e personelit kompetent.

D. Qeveria e Republikës së Shqipërisë do të bëjë çfarëdo përpjekjeje të nevojshme për të garantuar që asnjë fond ose mbështetje tjetër e parashikuar sipas kësaj Marrëveshjeje të mos përfshihet, në ndonjë mënyrë, në mbështetjen e trafikut të drogës.

#### 2. Të drejtat

Të drejtat për të gjithë pronën e prokuruar me fonde të siguruar nga Qeveria e SHBA-së, sipas kësaj Marrëveshjeje, do t'i përkasin Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, përjashtuar rastet kur saktësohet ndryshe.

#### 3. Prona dhe Personeli

##### A. Prona

1. Prona e dhënë Qeverisë së Republikës së Shqipërisë të Republikës së Shqipërisë nëpërmjet fondeve të siguruar nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara do të përdoret për të zhvilluar më tej objektin dhe qëllimin e kësaj Marrëveshjeje. Qeveria e Republikës së Shqipërisë do t'i kthejë Qeverisë së Shteteve të Bashkuara apo të rimbursojë Qeverinë e Shteteve të Bashkuara për çmimin fillestar të blerjes, të çdo prone që ajo përfiton përmes fondeve të siguruar nga qeveria e SHBA-së, e cila nuk është përdorur në përputhje me këtë dispozitë. Qeveria e Republikës së Shqipërisë nuk do të autorizojë rieksportimin, transferimin, dhënien hua, shitjen ose likuidimin e çfarëdo prone të dhënë në bazë të kësaj Marrëveshjeje pa autorizimin paraprak me shkrim të Qeverisë së SHBA-së.

Fondet që rrjedhin nga rieksportimi, transferimi, huaja, shitja apo disponimi i ndonjë prone të financuar nga Qeveria e SHBA-së për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë sipas kësaj Marrëveshjeje do të përdoren për të çuar më tej objektivat e kësaj Marrëveshjeje.

2. E gjithë prona e financuar apo e ofruar sipas kësaj Marrëveshjeje do të merret parasysh për Ambasadën e Shteteve të Bashkuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë në një mënyrë jo më pak rigorozë sesa do të përdoret nëse prona do të merret nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë me fondet e Qeverisë së Shqipërisë.

##### B. Personeli

1. Përpara se bursat apo trajnimi me pjesëmarrje për personelin të propozuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë mund të financohen apo të jepen sipas kësaj Marrëveshjeje, çdo person i tillë duhet të nënshkruajë një vërtetim, siç përcaktohet në shtojcën e kësaj Marrëveshjeje, që ai/ajo nuk është dënuar për ndonjë vepër penale në fushën e lëndëve narkotike dhe nuk ka qenë i përfshirë në trafikun e lëndëve narkotike gjatë dhjetë viteve të fundit.

2. Në mënyrë që të ketë përfitimet maksimale nga investimi në trajnim, Qeveria e Republikës së Shqipërisë bie dakord të mbajë personelin që ka marrë trajnim të financuar ose të ofruar sipas kësaj Marrëveshjeje për një periudhë minimale prej dy vjetësh pas përfundimit të një trajnimi të tillë. Nga kjo dispozitë mund të hiqet dorë nëpërmjet një marrëveshjeje me shkrim të Palëve.

##### 4. Mbikëqyrja dhe Vlerësimi

A. Çdo Palë do të ketë të drejtë: 1) të shqyrtojë çfarëdo prone të financuar apo të dhënë nga ajo Palë sipas kësaj Marrëveshjeje, për të përcaktuar se ajo prone po përdoret në përputhje me kushtet e kësaj Marrëveshjeje; dhe 2) të inspektojë dhe revizionojë të dhënat dhe llogaritë në lidhje me fondet, pronën ose shërbimet e financuara ose të dhëna nga kjo Palë sipas kësaj Marrëveshjeje, për të përcaktuar se këto fonde, prona dhe shërbime po përdoren në përputhje me kushtet e kësaj Marrëveshjeje.

B. Palët do të mbikëqyrin ecurinë e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, duke përfshirë përdorimin e fondeve, pronave dhe shërbimeve të financuara apo të dhëna sipas kësaj Marrëveshjeje të paktën një herë në vit. Çdo Palë do të caktojë personel të kualifikuar për pjesëmarrje në procesin e monitorimit dhe të vlerësimit.

C. Çdo Palë do t'i japë palës tjetër informacionin e nevojshëm për të vlerësuar efektshmërinë e aktiviteteve të projektit sipas kësaj Marrëveshjeje. Në fund të këtij projekti, do të lëshohet një raport i plotësuar. Ky raport do të përfshijë një



përmbledhje të kontributeve të projektit të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe të Shteteve të Bashkuara, një dosje të aktiviteteve të kryera, objektivat e arritur dhe të dhënat përkatëse.

#### 5. Ligjet në fuqi

A. Çdo Palë do të shpenzojë fondet dhe mbështetëse aktivitetet, e projektit në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi.

B. E gjithë prona e mbështetur apo financuar nga Qeveria e SHBA-së, sipas kësaj Marrëveshjeje, do të prokurorhet dhe do të dërgohet nga Shtetet e Bashkuara, nëse nuk parashikohet ndryshe në këtë Marrëveshje ose në ndonjë shtojcë të projektit ose siç autorizohet ndryshe me shkrim nga Qeveria e SHBA-së.

#### 6. Taksa

##### A. Pronësia dhe Fondet

Çdo pronë apo fond i futur apo i përfutur në Shqipëri nga Qeveria e SHBA-së ose nga çfarëdo personi apo subjekti (duke përfshirë, por pa u kufizuar te kontraktuesit dhe fondacionet) të financuar nga Qeveria e SHBA-së si pjesë ose në lidhje me këtë Marrëveshje do të përjashtohet nga të gjitha taksat, pagesat e shërbimit dhe kërkesat e investimit ose të depozitave dhe kontrollet valutore në Shqipëri. Importi, eksporti, përdorimi apo disponimi i një prone të tillë apo i fondeve në lidhje me këtë Marrëveshje do të përjashtohet nga të gjitha tatimet e importit, tatimet doganore, akcizat, TVSH-ja, tarifatat e inspektimit dhe detyrimet e eksportit, si dhe çdo lloj takse ose detyrimi të ngjashëm që përfshin penalitetet ose gjobat në Shqipëri. Në rast se taksat (duke përfshirë tatimet, TVSH-në, taksat e tjera ose detyrime të ngjashme, penalitete ose gjoba) janë vlerësuar, Shqipëria bie dakord që t'i rimbursojë në kohë Qeverisë së Shteteve të Bashkuara një shumë të barabartë me një vlerësim të tillë.

##### B. Personeli i Qeverisë së SHBA-së

Të gjithë pjesëtarët e personelit të punësuar nga Qeveria e SHBA-së dhe të caktuar nga Qeveria e SHBA për kryerjen e detyrave të tyre në Shqipëri në lidhje me këtë Marrëveshje dhe anëtarët shoqëruar të familjeve të tyre, do të përjashtohen nga të gjitha taksat shqiptare mbi të ardhurat dhe taksat e sigurimeve shoqërore në lidhje me të ardhurat e fituara gjatë kohës së qëndrimit në Shqipëri, dhe nga taksat e pronës për pronën e patundshme ose personale që gjendet në Shqipëri dhe të synuar për përdorimin e tyre personal. Këta

pjesëtarë personeli dhe anëtarët shoqëruar të familjeve të tyre do t'i nënshtrohen të njëjtut trajtim në lidhje me pagesën e tatimeve doganore dhe të importit për sendet personale, pajisjet dhe furnizimet e importuara në Shqipëri për përdorimin e tyre vetjak, siç është vendosur nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë për agjentët diplomatikë të Ambasadës së SHBA-së në Shqipëri.

##### C. Shërbimet e kontratës

Çdo kontraktues me qëndrim jo të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë çfarëdo firme konsulence, çfarëdo personeli joshqiptar të një kontraktuesi të tillë të financuar sipas kësaj Marrëveshjeje dhe i pranishëm në Shqipëri për të kryer punë në lidhje me këtë Marrëveshje, çfarëdo prone apo transaksioni që lidhet drejtpërdrejt me kontrata të tilla, dhe çfarëdo transaksioni për prokurimin e mallrave, i financuar sipas kësaj Marrëveshjeje do të përjashtohet nga të gjitha taksat, tarifatat, tatimet ose detyrimet e tjera, përfshirë penalitetet ose gjobat që vendosen në Shqipëri.

Në rastin kur taksat (duke përfshirë tatimet, TVSH-në, taksat e tjera ose detyrimet e ngjashme, penalitetet ose gjobat) janë vlerësuar, Shqipëria bie dakord për t'i rimbursuar në kohë Qeverisë së SHBA-së një sasi të barasvlershme me këtë vlerësim.

D. Marrëveshjet tatimore të parashikuara në paragrafët B dhe C nuk janë të zbatueshme për qytetarët ose personat me qëndrim të përhershëm në Shqipëri, të pranishëm në Shqipëri, në lidhje me këtë Marrëveshje.

#### 7. Statusi i Personelit të Qeverisë së SHBA-ve në Shqipëri

A. Qeveria e Shqipërisë do të presë personat e caktuar nga Qeveria e SHBA-së për të përmbushur përgjegjësitë e Qeverisë së SHBA-së, sipas kësaj Marrëveshjeje. Pas njoftimit të përshtatshëm nga Qeveria e SHBA-së, Qeveria e Republikës së Shqipërisë do t'u ofrojë punonjësve të Qeverisë Amerikane që përmbushin përgjegjësi sipas kësaj Marrëveshjeje, privilegje dhe imunitete të barasvlershme me ato që u jepen stafit administrativ dhe teknik të Ambasadës së SHBA-së, në bazë të Konventës së Vjenës mbi Marrëdhëniet Diplomatike të vitit 1961. Asgjë në këtë Marrëveshje nuk interpretohet të shmangë privilegjet dhe imunitetet e dhëna personelit të tillë në bazë të marrëveshjeve të tjera.



B. Privilegjet dhe imunitetet e parashikuara në paragrafin A nuk janë të zbatueshme për qytetarët apo banorët e përhershëm të Shqipërisë, aktualisht në Shqipëri, në lidhje me këtë Marrëveshje.

#### 8. Të drejtat e njeriut

Palët pranojnë se mbrojtja e të drejtave të njeriut është një element i rëndësishëm i kësaj Marrëveshjeje. Për këtë qëllim, Palët kuptojnë se:

A. Ndhimja e Qeverisë së SHBA-së për Zhvillimin e Sektorit të Drejtësisë të Qeverisë Shqiptare kushtëzohet nga mënyra aktive e mbrojtjes së të drejtave të njeriut në Shqipëri nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë; dhe

B. Në përputhje me ligjin dhe politikën e Shteteve të Bashkuara dhe me seksionin 620M të Aktit të Ndhimës së Jashtme të vitit 1961, të ndryshuar, asnjë ndihmë apo fond i Qeverisë së SHBA-së nuk do të sigurohet sipas kësaj Marrëveshjeje për përdorim nga një njësi e forcave të sigurisë të Qeverisë Shqiptare, nëse qeveria e SHBA-së ka informacion të besueshëm se një njësi e tillë ose një anëtar i njësisë ka kryer një shkelje të rëndë të të drejtave të njeriut, nëse qeveria e SHBA-së nuk konstaton se Qeveria e Republikës së Shqipërisë është duke marrë masa efektive për të sjellë anëtarët përgjegjës të njësisë së forcave të sigurisë para drejtësisë.

Qeveria e Republikës së Shqipërisë pranon t'i dorëzojë Qeverisë Amerikane emrat e pjesëmarrësve të synuar dhe çdo informacion tjetër që mund të jetë i nevojshëm për të përfunduar inspektimin paraprak të individëve të tillë, duke përfshirë edhe njësinë e tyre të detyrës, jo më pak se dyzet e pesë ditë para datës së synuar të fillimit të trajnimit. Palët e kuptojnë se në bazë të kësaj Marrëveshjeje, asnjë trajnim ose përfitim tjetër nuk mund të sigurohet për ndonjë individ ose njësi, derisa Qeveria Amerikane të konfirmojë se individit ose njësisë është e pranueshme. Palët kuptojnë se “masa efektive” do të thotë se Qeveria e Republikës së Shqipërisë është duke kryer një hetim të besueshëm dhe se individët e përfshirë do të përballen me masat e duhura disiplinore apo ndjekjen e paanshme penale në përputhje me ligjin shqiptar.

#### 9. Dispozitat përfundimtare

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim, me anë të të cilit palët njoftojnë njëra-tjetrën për përfundimin e procedurave të brendshme ligjore që kërkohen për

hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje.

A. Ndryshimet në këtë Marrëveshje mund të bëhen siç është rënë dakord nga Palët dhe të deklaruar si ndryshime në këtë Marrëveshje.

B. Secila palë mund ta përfundojë këtë Marrëveshje duke i dhënë Palës tjetër njoftim paraprak me shkrim 90 ditë para, në lidhje me qëllimin e saj. Qeveria Amerikane mund të pezullojë detyrimet e saj sipas kësaj Marrëveshjeje në tërësi ose pjesërisht me dhënien e njoftimit me shkrim për Qeverinë Shqiptare, me efekt të menjëhershëm.

C. Pavarësisht nga procedurat e njoftimit të parashikuara në paragrafin C, Qeveria Amerikane rezervon të drejtën për të ndërprerë të gjithë ndihmën e dhënë në bazë të kësaj Marrëveshjeje menjëherë pas njoftimit apo për të marrë ndonjë masë tjetër të përshtatshme, në qoftë se një institucion i Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, të cilit ose nëpërmjet të cilit jepet ndihma në bazë të kësaj Marrëveshjeje ose një individ kyç i institucionit, ose çdo përfitues burse apo trajnimi të mbështetur ose të financuar sipas kësaj Marrëveshjeje, është konstatuar të ketë qenë i dënuar për vepër penale në fushën e lëndëve narkotike ose kanë qenë të angazhuar në trafikun e drogës. Trafikimi i drogës është përcaktuar si çdo aktivitet i paligjshëm i ndërmarrë për të kultivuar, prodhuar, fabrikuar, shpërndarë, shitur, financuar ose transportuar ose për të ndihmuar, mbështetur, komplotuar apo bashkëpunuar me të tjerët në aktivitete të paligjshme, duke përfshirë pastrimin e parave (përcaktohet si proces ku të ardhurat e veprimtarisë kriminale janë transportuar, transferuar, transformuar, konvertuar ose përzier me fondet e fituara ligjërisht, me qëllim të fshehjes apo të maskimit të natyrës së vërtetë, burimit, disponimit, lëvizjes ose pronësisë së këtyre të ardhurave) në lidhje me drogat narkotike ose psikotrope, kimikate prekursorë apo substanca të tjera të kontrolluara. Një vepër penale në fushën e lëndëve narkotike është përcaktuar si një shkelje ose një komplot për të shkelur, ndonjë ligj apo rregullore të Shteteve të Bashkuara, të një shteti, Distriktit të Kolumbisë apo territor tjetër të SHBA-së ose në një vend të huaj që ka të bëjë me narkotikë apo droga psikotrope apo substanca të tjera të kontrolluara.

D. Pavarësisht përfundimit të kësaj Marrëveshjeje, detyrimet e Qeverisë së Republikës së





Shqipërisë të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë sipas seksionit V, paragrafi 3 i kësaj Marrëveshje, në lidhje me shfrytëzimin e pronës, do të vazhdojnë të zbatohen pa afat kohor, nëse nuk është rënë dakord ndryshe me shkrim nga Palët.

E. Si kusht për disponueshmërinë e tyre të vazhdueshme, një pajtim vjetor i fondeve (auditim) mund të zbatohet ashtu siç diktohet nga kërkesat e vazhdueshme të raportimit të mbikëqyrjes së Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

Bërë në Tiranë, Shqipëri, në dy kopje, më 1 korrik 2015, në gjuhën angleze dhe në gjuhën shqipe, ku të dyja tekstet janë njëloj autentike.

Për Qeverinë e Shteteve të Bashkuara  
të Amerikës  
Donald Lu  
Ambasador

Për Këshillin e Ministrave të Republikës  
së Shqipërisë  
Saimir Tahiri  
Ministri i Punëve të Brendshme

**VËRTETIM PËR MOSPJESËMARRJE NË  
VEPRAT PENALE NË FUSHËN E  
LËNDËVE NARKOTIKE DHE TRAFIKIMIN  
E DROGËS**

1. Nëpërmjet kësaj certifikate unë pranoj se dhjetë vitet e fundit?

a) Unë nuk jam dënuar për ndonjë shkelje ose bashkëpunim për shkelje, të asnjë ligji apo rregulloreje të Shteteve të Bashkuara apo të ndonjë shteti tjetër, në lidhje me lëndët narkotike ose psikotrope apo substanca të tjera të ndaluara nga ligji.

b) Unë nuk jam dhe nuk kam qenë një trafikant i paligjshëm për droga apo substanca të tjera të kontrolluara.

c) Unë nuk jam dhe nuk kam qenë dëshmitar, bashkëfajtor, komplotist apo bashkëpunëtor me të tjerët në trafikimin e paligjshëm të drogës apo substancave të tilla.

2. Unë e kuptoj se Departamenti i Shtetit të Shteteve të Bashkuara (DSH) mund t'i japë fund trajnimit tim në qoftë se arrihet në përfundimin që unë jam përfshirë në veprimet e mësipërme gjatë dhjetë viteve të fundit ose gjatë trajnimit tim të financuar nga DSH-ja.

Firma: \_\_\_\_\_

Emri: \_\_\_\_\_

Data: \_\_\_\_\_

**SHËNIM**

1. Në bazë të marrëveshjeve ndërmjet Qeverisë Amerikane dhe asaj të Shqipërisë, ju kërkohet të nënshkruani këtë vërtetim.

2. Në qoftë se jepni të dhëna të rreme në këtë vërtetim, ju i nënshtrohni një procedimi penal sipas ligjeve në fuqi.

**LIGJ  
Nr. 82/2015**

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES  
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË  
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE  
QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË  
GJERMANISË PËR BASHKËPUNIMIN  
FINANCIAR 2011, PËR PROJEKTIN  
“PROGRAM PËR SEKTORIN E  
UJIT/PROGRAM PËR FURNIZIMIN E  
ZONAVE RURALE ME UJË, III”**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar 2011, për projektin “Program për sektorin e ujit/program për furnizimin e zonave rurale me ujë, III”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji dhe pjesëve përbërëse të tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 23.7.2015

**Shpallur me dekretin nr. 9194, datë 30.7.2015  
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bujar Nishani**



## MARRËVESHJE

### NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË MBI BASHKËPUNIMIN FINANCIAR 2011 PËR PROJEKTIN “PROGRAM PËR SEKTORIN E UJIT/PROGRAM PËR FURNIZIMIN E ZONAVE RURALE MË UJË III”

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë,

*në frymën e marrëdhënieve ekzistuese miqësore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë;*

*duke u nisur nga dëshira për t'i forcuar dhe thëlluar këto marrëdhënie miqësore nëpërmjet Bashkëpunimit Financiar si partnerë;*

*të ndërgjegjshme se ruajtja e këtyre marrëdhënieve përbën bazën e kësaj marrëveshjeje;*

*me qëllim për të kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë;*

*duke iu referuar premtimit të Ambasadës së Republikës Federale të Gjermanisë (Notë verbale nr. 164/2011, e datës 21 shtator 2011),*

*u morën vesh si vijon:*

#### Neni 1

1. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Shqipërisë ose një huamarrësi tjetër, i cili do të zgjidhet bashkërisht nga të dyja Qeveritë, të marrë për projektin “Program për sektorin e ujit/program për furnizimin e zonave rurale më ujë III” një hua me kushte të favorshme nga Kreditanstalt für Wiederaufbau (KfW), e cila akordohet në kuadër të bashkëpunimit publik zhvillimor, me vlefte prej deri në 24.000.000 eurosh (me fjalë: njëzet e katër milionë euro), kur nga shqyrtimi përkatës ka rezultuar se projekti vlen për t'u mbështetur në kuadër të politikës zhvillimore dhe kur Shqipëria vazhdon të jetë e besueshme lidhur me kreditë dhe kur Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë jep garanci shtetërore, në rast se ai vetë nuk bëhet huamarrës. Projekti në fjalë nuk mund të zëvendësohet me projekte të tjera.

2. Në rast se Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë në një kohë të mëvonshme i jep Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të marrë nga Kreditanstalt für Wiederaufbau hua

ose shuma të tjera financimi për përgatitjen e projektit të përmendur në paragrafin 1, atëherë gjen zbatim kjo marrëveshje.

3. Shumat e financimit për masa përgatitore dhe shoqëruese do të kthehen në hua, në rast se ato nuk përdoren për masa të tilla.

#### Neni 2

1. Përdorimi i shumës së përmendur në nenin 1, kushtet me të cilat vihet në dispozicion ajo, si dhe procedura e dhënies së porosisë përcaktohen në kontratat që do të përfundohen midis Kreditanstalt für Wiederaufbau dhe marrësve të huas dhe të shumave të financimit, të cilat u nënshtrohen dispozitave ligjore që janë në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë.

2. Premtimi i shumës së përmendur në nenin 1, paragrafi 1 nga viti buxhetor 2008 do të zhvleftësohet, në rast se kontratat përkatëse të huadhënies nuk përfundohen brenda një afati prej tetë vjetësh pas vitit të premtimit. Për shumën e përmendur në nenin 1, paragrafi 1, ky afat mbaron në datën 31 dhjetor 2016.

3. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ai vetë nuk është huamarrës, do të garantojë ndaj Kreditanstalt für Wiederaufbau të gjitha pagesat me euro për shlyerjen e borxheve të huamarrësve, në bazë të kontratave, të cilat do të përfundohen sipas paragrafit 1.

4. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ai vetë nuk është marrësi i shumave të financimit, do të garantojë ndaj Kreditanstalt für Wiederaufbau pretendimet eventuale lidhur me shlyerjen, që mund të lindin në bazë të kontratave për financim, të cilat do të përfundohen sipas paragrafit 1.

#### Neni 3

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e liron Kreditanstalt für Wiederaufbau nga të gjitha taksat e tjera publike, të cilat merren në Republikën e Shqipërisë lidhur me përfundimin dhe zbatimin e kontratave të përmendura në nenin 2, paragrafi 1.

#### Neni 4

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i lejon pasagjerët dhe furnizuesit të zgjedhin lirisht



ndërmarrjet transportuese për transportimin e personave dhe të mallrave në rrugë detare, tokësore dhe ajrore që rezultojnë nga dhënia e huas dhe e shumave të financimit, nuk merr asnjë masë, e cila përjashton ose vështirëson pjesëmarrjen me të drejta të barabarta të ndërmarrjeve transportuese me qendër në Republikën Federale të Gjermanisë, dhe nxjerr në rastet e duhura lejet e nevojshme për pjesëmarrjen e këtyre ndërmarrjeve transportuese.

## Neni 5

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën, kur Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i njofton Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, se janë përmbushur kushtet brendashtetërore për hyrjen në fuqi. Përcaktuese është dita e marrjes së njoftimit.

Bërë në Tiranë, \_\_\_\_\_, në dy origjinale, secila në gjuhën shqipe dhe gjermane, duke pasur të dyja tekstet fuqi të barabartë.

## LIGJ

Nr. 83/2015

**PËR RATIFIKIMIN E  
MARRËVESHJES NDËRMJET  
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË  
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE  
QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE  
TË GJERMANISË PËR  
BASHKËPUNIMIN FINANCIAR 2011,  
PËR MASËN SHOQËRUESE TË  
PROJEKTIT “PROGRAM PËR  
SEKTORIN E UJIT/PROGRAM PËR  
FURNIZIMIN E ZONAVE RURALE ME  
UJË, III”**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

## KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

## VENDOSI:

## Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar 2011, për masën shoqëruuese të projektit “Program për sektorin e

ujit/program për furnizimin e zonave rurale me ujë, III”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji dhe pjesëve përbërëse të tij.

## Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 23.7.2015

**Shpallur me dekretin nr. 9195, datë 30.7.2015  
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bujar Nishani**

## MARRËVESHJE

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE  
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE  
QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE  
TË GJERMANISË PËR BASHKËPUNIMIN  
FINANCIAR 2011, PËR MASËN  
SHOQËRUESE TË PROJEKTIT  
“PROGRAM PËR SEKTORIN E  
UJIT/PROGRAM PËR FURNIZIMIN E  
ZONAVE RURALE MË UJË III”

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë, në frymën e marrëdhënieve ekzistuese miqësore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë;

duke u nisur nga dëshira për t'i forcuar dhe thelluar këto marrëdhënie miqësore nëpërmjet Bashkëpunimit Financiar si partnerë; të ndërgjegjshme se ruajtja e këtyre marrëdhënieve përbën bazën e kësaj marrëveshjeje;

me qëllim për të kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë;

duke iu referuar premtimit të Ambasadës së Republikës Federale të Gjermanisë (notë verbale nr. 197/2011, e datës 23 nëntor 2011) dhe protokollit të bisedimeve ndërqeveritare, të datës 8 maj 2014,

kanë rënë dakord si vijon:

## Neni 1

1. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Shqipërisë ose marrësve të tjerë, të cilët do të zgjidhen bashkërisht nga të dyja Qeveritë, të marrin nga Kreditanstalt für Wiederaufbau (KfW) një shumë financimi me vlerë prej deri në 1 500 000 eurosh



(me një fjalë: një milion pesëqind mijë euro) për masa të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit “Program për sektorin e ujit/program për furnizimin e zonave rurale me ujë III”, nëse nga shqyrtimi përkatës ka rezultuar se masat në fjalë vlejné për t’u mbështetur dhe është konfirmuar se ato plotësojnë kushtet e posaçme për mbështetjen nëpërmjet një shume financimi, duke qenë masa në fushën e përmirësimit të pozitës shoqërore të grave ose masa për luftimin e varfërisë, duke u mbështetur në parimin e vetëndihmës, ose fonde garantuese të kredive për ndërmarrje të mesme, ose projekte në fushën e infrastrukturës sociale ose të mbrojtjes së mjedisit.

2. Po të bien dakord Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë dhe Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë, projekti i përmendur në paragrafin 1 mund të zëvendësohet me projekte të tjera. Në rast se projekti zëvendësohet me një projekt, i cili plotëson kushtet e posaçme për mbështetjen nëpërmjet një shume financimi, duke qenë një projekt në fushën e mbrojtjes së mjedisit ose të infrastrukturës sociale ose një fond garantues i kredive për ndërmarrje të mesme, ose një masë për luftimin e varfërisë, duke u mbështetur në parimin e vetëndihmës, ose një masë, e cila i shërben përmirësimit të pozitës shoqërore të grave, atëherë mund të akordohet një shumë financimi, në të kundërt mund të jepet një hua.

3. Në rast se Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë në një kohë të mëvonshme i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të marrë nga Kreditanstalt für Wiederaufbau hua ose shuma të tjera financimi për përgatitjen e projektit të përmendur në paragrafin 1 ose shuma të tjera financimi për masa të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit të përmendur në paragrafin 1, gjen zbatim kjo marrëveshje.

4. Shumat e financimit për masa përgatitore dhe shoqëruese do të kthehen në hua, në rast se ato nuk përdoren për masa të tilla.

#### Neni 2

1. Përdorimi i shumës së përmendur në nenin 1, kushtet me të cilat vihet në dispozicion ajo, si dhe procedura e dhënies së porosisë përcaktohen në kontratat që do të përfundohen midis Kreditanstalt für Wiederaufbau dhe marrësve të huas dhe të shumës së financimit, të cilat u nënshtrohen

dispozitave ligjore që janë në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë.

2. Premtimi i shumës së përmendur në nenin 1 do të zhvleftësohet, në rast se kontratat përkatëse për financim nuk lidhen brenda një afati prej tetë vjetësh pas vitit të premtimit. Për këtë shumë, ky afat mbaron në datën 31 dhjetor 2019.

3. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ai vetë nuk është marrësi i shumës së financimit, do të garantojë ndaj Kreditanstalt für Wiederaufbau pretendimet e mundshme për shlyerjen, që mund të lindin në bazë të kontratave për financim, të cilat do të lidhen sipas paragrafit 1.

#### Neni 3

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e liron Kreditanstalt für Wiederaufbau nga të gjitha tatimet dhe taksat e tjera publike, të cilat merren në Republikën e Shqipërisë lidhur me përfundimin dhe zbatimin e kontratave të përmendura në nenin 2, paragrafi 1.

#### Neni 4

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i lejon pasagjerët dhe furnizuesit të zgjedhin lirisht ndërmarrjet transportuese për transportimin e personave dhe të mallrave në rrugë detare, tokësore dhe ajrore, transport ky që rezulton nga dhënia e huas dhe e shumave të financimit, si dhe nuk merr asnjë masë, e cila përjashton ose vështirëson pjesëmarrjen me të drejta të barabarta të ndërmarrjeve transportuese me seli në Republikën Federale të Gjermanisë, dhe nxjerr sipas rastit lejet e nevojshme për pjesëmarrjen e këtyre ndërmarrjeve transportuese.

#### Neni 5

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën, kur Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i njofton Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, se janë përmbushur kushtet brendashtetërore për hyrjen në fuqi. Përcaktuese është dita e marrjes së njoftimit.

Bërë në Tiranë, \_\_\_\_\_, në dy origjinale, secila në gjuhën shqipe dhe gjermane, duke pasur të dyja tekstet fuqi të barabartë.



**LIGJ**  
**Nr. 84/2015**

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË  
GARANCISË NDËRMJET REPUBLIKËS  
SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR  
NGA MINISTRIA E FINANCAVE, DHE  
KfW FRANKFURT AM MAIN, NË LIDHJE  
ME MARRËVESHJEN E HUAS, NË  
SHUMËN 40 MILIONË EURO,  
NDËRMJET OPERATORIT TË SISTEMIT  
TË TRANSMETIMIT SHA (OST), DHE  
KfW, NË MBËSHTETJE TË PROJEKTIT  
“EFICIENCA ENERGETIKE –  
PROGRAMI PËR SEKTORIN E  
TRANSMETIMIT TË ENERJISË  
ELEKTRIKE”**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e garancisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë, garantuesi, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe KfW Frankfurt am Main, në lidhje me marrëveshjen e huas, në shumën 40 milionë euro, ndërmjet Operatorit të Sistemit të Transmetimit, sh. a., (OST), huamarrësi, dhe KfW, në mbështetje të projektit “Eficiencia energjetike - programi për sektorin e transmetimit të energjisë elektrike”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji dhe pjesëve përbërëse të tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 23.7.2015

**Shpallur me dekretin nr. 9196, datë 30.7.2015 të  
Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar  
Nishani**

**MARRËVESHJE GARANCIE**

E DATËS \_\_\_\_\_, NDËRMJET KfW,  
FRANKFURT AM MAIN (KfW) DHE  
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË  
(GARANTUESI) TË PËRFAQËSUAR NGA  
MINISTRIA E FINANCAVE NË LIDHJE ME  
MARRËVESHJEN E HUAS NË SHUMËN  
40,000,000.00 (DYZETË MILIONË EURO)  
EURO TË DATËS \_\_\_\_\_, MIDIS KfW-SË  
DHE OPERATORIT TË SISTEMIT TË  
TRANSMETIMIT SHA (OST) (HUAMARRËSI)  
NË MBËSHTETJE TË EFICIENCËS  
ENERGETIKE, PROGRAMI PËR  
SEKTORIN E TRANSMETIMIT TË  
ENERJISË ELEKTRIKE  
(BMZ NR. 2011 66 388)

Hyrje

Nëpërmjet një marrëveshje huaje të datës \_\_\_\_\_ 2015, (Marrëveshja e Huas) midis Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a. (OST) (Huamarrësi) dhe KfW-së (KfW), KfW-ja ka rënë dakord t'i japë Huamarrësit një hua e cila nuk tejkalon shumën e 40,000,000.00 euro (Huaja), sipas termave dhe duke iu nënshtruar kushteve të përfshira në Marrëveshjen e Huas.

Ekzekutimi dhe livrimi i kësaj Marrëveshjeje Garancie është kusht paraprak për çdo disbursim sipas Marrëveshjes së Huas.

Garantuesi është njohur me termat dhe kushtet e marrëveshjes së huas.

Bazuar në sa më lart, Garantuesi bie dakord si më poshtë:

Neni 1

1.1 Garantuesi, në mënyrë të përvokueshme dhe të pakushtëzuar, i garanton KfW-së përmbushjen në kohë të të gjitha detyrimeve të pagesës së Huamarrësit sipas Marrëveshjes së Huas.

1.2 Pas kërkesës së parë me shkrim nga ana e KfW-së në të cilën përcaktohet se Huamarrësi nuk i ka përmbushur detyrimet e tij të pagesës, sipas mënyrës dhe afatit të caktuar, Garantuesi paguan menjëherë shumën e kërkuar pa asnjë kompensim, rezervë, zbritje, kundërpretendim, kundërshtim apo mbrojtje tjetër, ekskluzivisht në euro, për llogari të KfW-së, Frankfurt am Main,

Marrësi: KfW Bankengruppe

SWIFT-BIC: KFWIDEFF

IBAN: DE 5002 0400 3197 5089 93



1.3 Detyrimet e pagesës së Garantuesit ekzistojnë pavarësisht vlefshmërisë së Marrëveshjes së Huas, çdo informacioni paraprak ose kërkesë për pagesë nga KfW-ja për Huamarrësin, çdo procesi gjyqësor apo veprimi tjetër juridik të iniciuar nga KfW-ja kundër Huamarrësit, ose çdo dëshmie të paaftësisë paguese të Huamarrësit që jepet nga KfW-ja.

Neni 2

Ndryshimet apo amendimet në Marrëveshjen e Huas nuk kërkojnë pëlqimin e Garantuesit. Megjithatë, ky i fundit merr përgjegjësi për detyrimet shtesë të pagesës vetëm nëse do të ketë rënë dakord për ndryshimet apo amendimet përkatëse.

Neni 3

Pa cenuar detyrimet e tjera të Garantuesit sipas kësaj Marrëveshjeje, Garantuesi, duke ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme dhe të duhura, brenda kompetencave të tij dhe në përputhje me praktikën e qëndrueshme inxhinierike dhe financiare, mbështet Huamarrësin për zbatimin dhe funksionimin e projektit dhe kryerjen e detyrimeve të Huamarrësit sipas Marrëveshjes së Huas.

Neni 4

Për sa kohë që Garantuesi u nënshtrohet detyrimeve reale ose të kushtëzuara sipas kësaj Marrëveshjeje, nuk gëzon të drejtën e kalimit të përgjegjësisë në lidhje me shumën e paguar nga ai sipas kësaj Marrëveshjeje.

Neni 5

5.1 Para kryerjes së disbursimit të parë, Garantuesi dëshmon, në formën dhe përmbajtjen e pranueshme për KfW-në, se KfW-ja përjashtohet nga të gjitha tatimet, tarifat, taksat dhe kosto të ngjashme në Republikën e Shqipërisë, mbi të gjitha pagesat që bëhen nga Garantuesi sipas kësaj Marrëveshjeje Garancie.

5.2 Në çdo rast, të gjitha pagesat që bëhen nga Garantuesi sipas kësaj Marrëveshjeje Garancie, bëhen pa ndonjë zbritje ose mbajtje në burim. Nëse Garantuesi është i detyruar me ligj ose ndryshe për të bërë ndonjë zbritje apo mbajtje në burim për ndonjë shumë për t'iu paguar KfW-së, atëherë ai paguan shumën të tilla shtesë për të siguruar që KfW-ja merr një shumë neto të

barabartë me shumën që do të merrte në rast se nuk do të ishin bërë zbritjet apo mbajtjet e tilla në burim.

5.3 Të gjitha tatimet, tarifat, taksat, taksat e pullës dhe kosto të ngjashme rezultuese në lidhje me përfundimin dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Garancie jashtë Republikës Federale të Gjermanisë, merren përsipër nga Garantuesi. Çdo kosto e tillë rezultuese në Republikën Federale të Gjermanisë merret përsipër nga Garantuesi, nëse shkaktohet prej tij. Nëse ndonjë kosto e tillë për t'u mbuluar nga Garantuesi paguhet nga KfW-ja, Garantuesi rimbursion KfW-në, menjëherë dhe sipas kërkesës, pas paraqitjes së faturave, sipas rastit.

5.4 Të gjitha kostot dhe shpenzimet, duke përfshirë shpenzimet ligjore që rrjedhin nga ose në lidhje me përgatitjen, negocimin, ekzekutimin, regjistrimin, zbatimin, modifikimin, ruajtjen apo zbatimin e kësaj Marrëveshjeje të Garancisë, të drejtat e kësaj të fundit ose çfarëdo garancie apo dokument që i përket kësaj Marrëveshjeje do të përballohet nga Garantuesi. Nëse ndonjë kosto ose shpenzim i tillë paguhet nga KfW-ja, Garantuesi duhet të paguajë KfW-në menjëherë, sipas kërkesës, pas paraqitjes së faturave, sipas rastit.

Neni 6

6.1 Me anë të Kësaj Marrëveshjeje, Garantuesi konfirmon se të gjitha autorizimet e nevojshme në Republikën e Shqipërisë për përfundimin dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje të Garancisë dhe të Marrëveshjes së Huas janë dhënë në mënyrë të rregullt dhe vazhdojnë të jenë në fuqi dhe efekt të plotë.

6.2 Garantuesi njofton KfW-në, pa vonesë, për çdo ngjarje që mund të pengojë ose të rrezikojë zbatimin e duhur të Marrëveshjes së Huas ose të kësaj Marrëveshjeje Garancie.

Neni 7

7.1 Kjo Marrëveshje Garancie rregullohet nga, dhe interpretohet në përputhje me ligjet e Republikës Federale të Gjermanisë.

7.2 Vendi i përmbushjes së Marrëveshjes është Frankfurt am Main.

7.3 Të gjitha pretendimet e KfW-së sipas kësaj Marrëveshjeje Garancie përfundojnë pas pesë vjetësh, duke filluar nga fundi i vitit në të cilin një pretendim i tillë ka rezultuar dhe në të cilin KfW-ja



ka marrë dijëni për rrethanat që përbëjnë një pretendim të tillë apo mund të kishte marrë dijëni për to pa neglizhencë të tepërt.

7.4 Të gjitha mosmarrëveshjet që rrjedhin nga ose në lidhje me Marrëveshjen e Garancisë, të cilat nuk mund të zgjidhen në mënyrë miqësore, zgjidhen ekskluzivisht dhe përfundimisht nga një gjykatë arbitrazhi. Për këtë, gjen zbatim sa vijon:

a) Gjykata e arbitrazhit do të përbëhet nga një ose tre arbitra të cilët do të emërohen dhe veprojnë në përputhje me rregullat e arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC), të zbatueshme herë pas here.

b) Procedura e arbitrazhit do të zhvillohet në Frankfurt am Main. Procedura do të zhvillohet në gjuhën angleze.

7.5 Sipas kësaj Marrëveshjeje, asnjë pagesë ndaj KfW-së, qoftë në përputhje me ndonjë vendim ose gjykim apo urdhër të gjykatës ose mënyrë tjetër, nuk vepron për çlirimin e detyrimit të Garantuesit për të cilin bëhet kjo pagesë, në rast se, dhe derisa pagesa e plotë është marrë në llogarinë rrjedhëse të detyrimit në fjalë. Në masën që shumën e pagesës në fjalë, për shkak të këmbimeve të nevojshme në monedhën e llogarisë në të cilën është maturuar kjo pagesë, nuk plotëson shumën e detyrimit përkatës të shprehur në monedhën e llogarisë, Garantuesi i detyrohet KfW-së shumën e cila, pas këmbimit në monedhën e llogarisë ku është maturuar pagesa, nevojitet për të barazuar diferencën.

7.6 Në atë masë që Garantuesi, aktualisht apo në të ardhmen, në çdo juridiksion, mund të kërkojë, për vete ose asetet e tij, imunitet ndaj padive, ekzekutimit, konfiskimit ose një procesi tjetër juridik dhe në atë masë që në çdo juridiksion të tillë mund t'i atribuohet atij ose aseteve të tij një imunitet i tillë, Garantuesi, në mënyrë të parevokueshme pajtohet që të mos pretendojë dhe në mënyrë të parevokueshme heq dorë nga imuniteti i tillë në masën e plotë të lejuar nga ligjet e këtij juridiksioni.

7.7 Dispozitat e marrëveshjes së huas në lidhje me llogaritjen dhe pagesat në përgjithësi (neni 5) do të zbatohen *mutatis mutandis* për çdo pagesë për t'u bërë sipas kësaj Marrëveshjeje.

7.8 Deklaratat apo njoftimet dhe komunikimet në lidhje me këtë Marrëveshje Garancie dërgohen me letër me postë ajrore ose nëpërmjet transmetimit telematik, në adresat e mëposhtme:

Për KfW-në: KfW  
Postfach 11 11 41  
60046 Frankfurt am Main  
Bundesrepublik Deutschland  
Faks: +49 69 7431 2944

Për Garantuesin: Republika e Shqipërisë  
e përfaqësuar nga Ministria e Financave  
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 1  
Tiranë, Shqipëri  
Faks: +355 4 222 8494

Çdo deklaratë e tillë, njoftim ose komunikim konsiderohet të jetë pranuar:

a) nëse bëhet me shkresë, dërguar me postë ajrore, shtatë ditë pasi shkresa përkatëse të jetë dërguar me postë rekomande, tarifa të parapaguara; ose

b) nëse bëhet me transmetim telematik, kur ky transmetim të ketë përfunduar.

7.9 Nëse ndonjë nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje Garancie bëhet ligjrisht e pavlefshme, kjo pavlefshmëri nuk ndikon në vlefshmërinë e dispozitave të tjera. Boshllëqet që do të rezultojnë si pasojë, plotësohen me dispozita që janë në përputhje me frymën dhe qëllimin e kësaj Marrëveshjeje Garancie.

7.10 Kjo Marrëveshje Garancie është hartuar në gjuhën angleze në tri kopje origjinale. KfW-ja mban një origjinale.

Tiranë, sot \_\_\_\_\_, ditën e \_\_\_\_\_ 2015

Për Republikën e Shqipërisë të përfaqësuar nga  
Ministria e Financave

\_\_\_\_\_  
Ministri i Financave  
Frankfurt am Main  
Sot \_\_\_\_\_, ditën e \_\_\_\_\_ 2015  
Për  
KfW-në



## ANEKSI 1

Formular i Opinionit Ligjor të Konsulentit  
Ligjor të Garantuesit (Shtetëror)

[Emri dhe adresa e Konsulentit Ligjor]

\_\_\_\_\_  
(datë)KfW  
Palmengartenstrasse 5 - 9  
Postfach 11 11 41  
D-60325 Frankfurt am Main

Republika Federale e Gjermanisë

Marrëveshje Garancie, e datës \_\_\_\_\_,  
e lëshuar nga \_\_\_\_\_ (Garantuesi) në interes të  
KfW-së, Frankfurt am Main (KfW)

Të nderuar zotërinj,

Unë jam Ministër i Drejtësisë/konsulent ligjor për/kreu i departamentit ligjor të Garantuesit. Unë kam vepruar në këtë cilësi në lidhje me Marrëveshjen e Garancisë (Garancia), të datës \_\_\_\_\_, në favorin tuaj në lidhje me një hua që do të jepet nga ju për (Huamarrësin) në një shumë që nuk tejkalon euro/sipas termave dhe kushteve të Marrëveshjes së Huas nr. (Marrëveshja e Huas).

Për qëllimin e paraqitjes së këtij opinionimi kam shqyrtuar:

A. Një kopje autentike origjinale të nënshkruar të Marrëveshjes së Garancisë dhe Marrëveshjes së Huas;

B. Dokumentet organike të Garantuesit, në veçanti:

1. Kushtetutën e Republikës së (VENDIT) (më poshtë e referuar si “Republika”), të datës, të botuar sipas rregullave në, nr., faqe, e ndryshuar;

2. Ligjin/et nr., të datës, botuar sipas rregullave në, nr., faqe, i ndryshuar ëju lutem, vendosni, nëse ekzistojnë, ligjet rregulluese të lëshimit të garancive nga ana e Republikës, p.sh. ligjet për buxhetin];

3. ëju lutem referojuni dekreteve ose rezolutave të organeve qeveritare që lidhen me procedurat ose kushtet për garancitë e Republikës në përgjithësi ose Marrëveshjen e Garancisë në veçanti, siç publikohen/regjistrohen në mënyrë të rregullt];

dhe ligjeve të tjera, rregulloreve, certifikatave, të dhënave, regjistrimeve dhe dokumenteve që i kam çmuar të nevojshme apo të dëshirueshme për shqyrtim. Përveç kësaj, kam kryer hetime që sipas

mendimit tim kanë qenë të nevojshme ose të dëshirueshme, në mënyrë që të mund të jap këtë opinion.

Në përputhje me qëllimet e Nenit \_\_\_\_\_ të Marrëveshjes së Huas, jam i mendimit se sipas ligjeve të Republikës, prej kësaj date:

a) Në bazë të nenit të Kushtetutës/nenit të ligjit ëju lutem, specifikoni sipas rastit] Garantuesi ka të drejtë të lidhë Marrëveshjen e Garancisë dhe ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të autorizuar ekzekutimin, dorëzimin dhe përmbushjen e Marrëveshjes së Garancisë, në veçanti:

1. Rezolutën/at nr. të datës të Këshillit të Ministrave ëose: Komisionit Shtetëror për Garancitë//ju lutem, plotësoni sipas rastit];

2. ërezolutat e tjera, vendimet etj.].

b) Znj./z. (dhe znj./z.) është (janë) autorizuar në mënyrë të rregullt që individualisht/bashkërisht të nënshkruajnë Marrëveshjen e Garancisë në emër të Garantuesit. Marrëveshja e Garancisë e nënshkruar nga znj/z. (dhe znj/z.) është kryer në mënyrë të rregullt në emër të Garantuesit dhe përbën detyrimet ligjërisht detyruese të Garantuesit të zbatueshme me ligj ndaj tij, në përputhje me kushtet e tij.

c) Për ekzekutimin dhe përmbushjen e Marrëveshjes së Garancisë nga Garantuesi (duke përfshirë, pa kufizim, marrjen dhe transferimin për KfW-në të të gjitha shumave për t'u paguar sipas kësaj Marrëveshjeje në monedhën ose monedhat e caktuara aty), janë marrë autorizimet zyrtare, licencat, regjistrimet dhe/ose lejet e mëposhtme dhe janë në fuqi dhe efekt të plotë.

1. Miratim i ëBankës Qendrore/Bankës Kombëtare/\_] i datës, nr.;

2. Leje e ëAutoritetit Qeveritar/Ministrit të ] e datës, nr.;

3. ëju lutem, shënoni autorizimet e tjera zyrtare, licencat dhe/ose lejet].

Asnjë leje tjetër zyrtare, licenca, regjistrime dhe/ose miratime të ndonjë autoriteti qeveritar ose agjencie (duke përfshirë Bankën Qendrore /Kombëtare të Republikës) ose gjykate nuk janë të nevojshme ose të këshillueshme në lidhje me ekzekutimin dhe përmbushjen nga Garantuesi dhe vlefshmërinë dhe zbatueshmërinë e detyrimeve të tij sipas Marrëveshjes së Garancisë. Asnjë taksë pulle ose taksë e ngjashme ose detyrim nuk duhet të paguhet në lidhje me vlefshmërinë ose





zbatueshmërinë e Marrëveshjes së Garancisë.

d) Zgjedhja e ligjit gjerman për të rregulluar Marrëveshjen e Garancisë dhe paraqitjen në arbitrazh dhe juridiksion në përputhje me nenet \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_ të Marrëveshjes së Garancisë është e vlefshme dhe e detyrueshme. Vendimet e arbitrazhit dhe vendimet e marra në gjykatat e Republikës Federale të Gjermanisë kundër Garantuesit do të njihen dhe do të jenë të zbatueshme në Republikë sipas rregullave të mëposhtme.

e) Gjykatat e Republikës janë të lira të japin gjykimin e tyre të shprehur në monedhën ose monedhat e specifikuara në Marrëveshjen e Garancisë;

f) Ekzekutimi dhe përmbushja e Marrëveshjes së Garancisë nga Garantuesi përbën akt privat dhe tregtar dhe akt qeveritar ose publik. As Garantuesi dhe as ndonjë prej pasurive të tij nuk kanë të drejtë të përfitojnë imunitet ndaj arbitrazhit, padive, ekzekutimit, konfiskimit ose ndonjë procesi tjetër ligjor.

g) Në pajtim me ëju lutem, specifikoni marrëveshjen përkatëse të tatimit të dyfishtë dhe ligjet dhe rregulloret e zbatueshme në Republikë] Garantuesit nuk i kërkohet të bëjë ndonjë zbritje apo mbajtje në burim të ndonjë pagese që duhet të kryejë sipas Marrëveshjes së Garancisë dhe nëse vendoset më pas ndonjë zbritje ose mbajtje e tillë në burim, zbatohen dispozitat e nenit të Marrëveshjes së Garancisë me anë të të cilave Garantuesit i kërkohet të dëmshpërblejë KfW-në në përputhje me rrethanat.

Rrjedhimisht, detyrimet e Garantuesit sipas Marrëveshjes së Garancisë përbëjnë drejtpërdrejt dhe në mënyrë të pakushtëzuar detyrimet ligjore, të vlefshme dhe detyruese të Garantuesit, të cilat renditen dhe kanë detyrimin të renditen të paktën *pari passu* me të gjitha debitë aktuale dhe të ardhshme të Garantuesit dhe janë të zbatueshme ndaj Garantuesit në përputhje me kushtet e tyre.

Ky opinion ligjor kufizohet te ligjet e \_\_\_\_\_.

\_\_\_\_\_  
(vendi) (data) (emri)

Ministër i Drejtësisë/Shefi i Departamentit Ligjor/Këshilltar Ligjor për

Dokumente të bashkëlidhura:

Shënim. Ju lutemi, bashkëlidhni fotokopjet e vërtetuara të dokumenteve dhe dispozitat ligjore të përmendura më sipër (në lidhje me ligjet e gjata ose Kushtetutën e Republikës, një kopje e dispozitave përkatëse është e mjaftueshme) dhe, gjithashtu, siguroni për KfW-në një përkthim zyrtar në gjuhën angleze ose gjermane të secilit prej dokumenteve të mësipërme, përveç rasteve kur dokumenti i tillë është lëshuar në anglisht ose gjermanisht si gjuhë zyrtare ose nëse KfW-ja ka përcaktuar se një gjuhë tjetër është e pranueshme.

**LIGJ**  
**Nr. 86/2015**

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES  
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË  
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE  
QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË  
GJERMANISË PËR BASHKËPUNIMIN  
FINANCIAR 2010, PËR PROJEKTIN  
“RIFINANCIMI I NDËRMARRJEVE TË  
VOGLA DHE TË MESME NË ZONAT  
URBANE DHE RURALE, FAZA E DYTË”**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar 2010, për projektin “Rifinancimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në zonat urbane dhe rurale, faza e dytë”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 23.7.2015

**Shpallur me dekretin nr. 9198, datë 30.7.2015 të  
Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar  
Nishani**



## MARRËVESHJE

### NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR BASHKËPUNIMIN FINANCIAR 2010 PËR PROJEKTIN “RIFINANCIMI I NDËRMARRJEVE TË VOGLA DHE TË MESME NË ZONAT URBANE DHE RURALE, FAZA E DYTË”

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë,  
*në frymën e marrëdhënieve ekzistuese miqësore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë;*

*duke u nisur nga dëshira për t'i forcuar dhe thëlluar këto marrëdhënie miqësore nëpërmjet Bashkëpunimit Financiar si partnerë;*

*të ndërgjegjshme se ruajtja e këtyre marrëdhënieve përbën bazën e kësaj marrëveshjeje;*

*me qëllim për të kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë;*

*duke in referuar bisedime ndërqeveritare të datës 18 maj 2010,*

*u morën vesh si vijon:*

#### Neni 1

1. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë ua jep mundësinë Këshillit të Ministrave të Shqipërisë ose huamarrësve të tjerë, që do të zgjidhen bashkërisht nga të dyja Qeveritë, të marrin për projektin “Rifinancimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në zonat urbane dhe rurale, faza e dytë”, një hua me kushte të favorshme nga Kreditanstalt für Wiederaufbau, e cila akordohet në kuadër të bashkëpunimit publik zhvillimor, me vleftë prej deri në 10.000.000 eurosh (me fjalë: dhjetë milionë euro), kur nga shqyrtimi përkatës ka rezultuar se projekti vlen për t'u mbështetur në kuadër të politikës zhvillimore dhe kur Shqipëria vazhdon të jetë e besueshme lidhur me kredinë. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë zotohet të mos e pengojë projektin dhe të përkrahë Qeverinë e Republikës Federale të Gjermanisë kundrejt marrësit lidhur me pretendimet eventuale për kthimin e huas për shkak të përdorimit të saj të padrejtë. Projekti në fjalë nuk mund të zëvendësohet me projekte të tjera.

2. Në rast se Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë në një kohë të mëvonshme i jep

mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të marrë nga Kreditanstalt für Wiederaufbau hua ose shuma të tjera financimi për përgatitjen e projektit të përmendur në paragrafin 1 ose shuma të tjera financimi për masa të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit të përmendur në paragrafin 1, atëherë gjen zbatim kjo marrëveshje.

3. Shumat e financimit për masa përgatitore dhe shoqëruese sipas nenit 1, paragrafi 2 do të kthehen në hua, në rast se ato nuk përdoren për masa të tilla.

#### Neni 2

1. Përdorimi i shumës së përmendur në nenin 1, kushtet me të cilat vihet në dispozicion ajo, si dhe procedura e dhënies së porosisë përcaktohen në kontratat që do të përfundohen midis Kreditanstalt für Wiederaufbau dhe marrësve të huas dhe të shumës së financimit, të cilat u nënshtrohen dispozitave ligjore që janë në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë.

2. Premtimi i shumës së përmendur në nenin 1 do të zhvleftësohet, në rast se kontratat përkatëse të huadhënies dhe të financimit nuk përfundohen brenda një afati prej tetë vjetësh pas vitit të premimit. Për shumën e përmendur në nenin 1, ky afat mbaron në datën 31 dhjetor 2018.

#### Neni 3

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e liron Kreditanstalt für Wiederaufbau nga të gjitha taksat dhe tatimet e tjera publike, të cilat merren në Republikën e Shqipërisë lidhur me përfundimin dhe zbatimin e kontratave të përmendura në nenin 2, paragrafi 1.

#### Neni 4

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i lejon pasagjerët dhe furnizuesit të zgjedhin lirisht ndërmarrjet transportuese për transportimin e personave dhe të mallrave në rrugë detare, tokësore dhe ajrore që rezultojnë nga dhënia e huas dhe e shumave të financimit, dhe nuk merr asnjë masë e cila përjashton ose vështirëson pjesëmarrjen me të drejta të barabarta të ndërmarrjeve transportuese me qendër në Republikën Federale të Gjermanisë, dhe nxjerr në rastet e duhura lejet e nevojshme për pjesëmarrjen e këtyre ndërmarrjeve transportuese.



Neni 5

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën, kur Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i njofton Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, se janë përmbushur kushtet brendashtetërore për hyrjen në fuqi. Përcaktuese është dita e marrjes së njoftimit.

Bërë në Tiranë, \_\_\_\_\_, në dy origjinale, secila në gjuhën shqipe dhe gjermane, duke pasur të dyja tekstet fuqi të barabartë.

**LIGJ**  
**Nr. 87/2015**

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES  
NDËRMJET KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË  
SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË  
REPUBLIKËS FEDERALE TË  
GJERMANISË PËR BASHKËPUNIMIN  
FINANCIAR 2009, PËR PROJEKTIN  
“ENERGJIA UJORE DHE SIGURIA E  
DIGAVE NË KASKADËN E DRINIT”**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar 2009, për projektin “Energjia ujore dhe siguria e digave në kaskadën e Drinit”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 23.7.2015

**Shpallur me dekretin nr. 9199, datë 30.7.2015  
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bujar Nishani**

**MARRËVESHJE**

**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE  
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE  
QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË  
GJERMANISË PËR BASHKËPUNIMIN  
FINANCIAR 2009 PËR PROJEKTIN  
“ENERGJIA UJORE DHE SIGURIA E  
DIGAVE NË KASKADËN E DRINIT”**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë,  
*në frymën* e marrëdhënieve ekzistuese miqësore ekzistuese ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë;

*duke u nisur* nga dëshira për t’i forcuar dhe thelluar këto marrëdhënie miqësore nëpërmjet Bashkëpunimit Financiar si partnerë;

*të ndërgjegjshëm* se ruajtja e këtyre marrëdhënieve përbën bazën e kësaj marrëveshjeje;

*me qëllim* për të kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë;

*duke iu referuar* premtimit të Ambasadës së Republikës Federale të Gjermanisë (notë verbale nr. 125/09, e datës 25 shtator 2009),

u morën vesh si vijon:

Neni 1

1. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Shqipërisë të marrë për projektin “Energjia ujore dhe siguria e digave në kaskadën e Drinit” numri i projektit: 2009.6653.1, nga Kreditanstalt für Wiederaufbau (KfW) një hua me kushte të favorshme, e cila akordohet në kuadër të bashkëpunimit publik zhvillimor, me vleftë prej deri në 20.000.000 eurosh (me fjalë: njëzet milionë euro), kur nga shqyrtimi përkatës ka rezultuar se projekti vlen për t’u mbështetur në kuadër të politikës zhvillimore dhe kur Republika e Shqipërisë vazhdon të jetë e besueshme lidhur me kreditë dhe kur Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë jep garanci shtetërore, në rast se ai vetë nuk është huamarrës. Projekti në fjalë nuk mund të zëvendësohet me projekte të tjera.

2. Në rast se Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë në një kohë të mëvonshme i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të marrë nga Kreditanstalt für Wiederaufbau hua ose shuma të tjera financimi për përgatitjen e projektit të përmendur në paragrafin 1



ose shuma të tjera financimi për masa të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit të përmendur në paragrafin 1, atëherë gjen zbatim kjo marrëveshje.

3. Shumat e financimit për masa përgatitore dhe shoqëruese sipas paragrafin 2 do të kthehen në hua, në rast se ato nuk përdoren për masa të tilla.

#### Neni 2

1. Përdorimi i shumës së përmendur në nenin 1, kushtet me të cilat vihet në dispozicion ajo, si dhe procedura e dhënies së porosisë përcaktohen në kontratat që do të përfundohen midis Kreditanstalt für Wiederaufbau dhe marrësve të huave dhe të shumave të financimit, të cilat u nënshtrohen dispozitave ligjore që janë në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë.

2. Premtimi i shumës së përmendur në nenin 1, paragrafi 1 do të zhvleftësohet, në rast se kontratat përkatëse të huadhënies nuk përfundohen brenda një afati prej tetë vjetësh pas vitit të premimit. Për shumën në fjalë, ky afat mbaron në datën 31 dhjetor 2017.

3. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ai vetë nuk është huamarrës, do të garantojë ndaj Kreditanstalt für Wiederaufbau të gjitha pagesat me euro për shlyerjen e borxheve të huamarrësve në bazë të kontratave, të cilat do të përfundohen sipas paragrafit 1.

4. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ai vetë nuk është marrësi i shumave të financimit, do të garantojë ndaj Kreditanstalt für Wiederaufbau pretendimet eventuale lidhur me shlyerjen, që mund të lindin në bazë të kontratave për financim, të cilat do të përfundohen sipas paragrafit 1.

#### Neni 3

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e liron Kreditanstalt für Wiederaufbau nga të gjitha taksat dhe tatimet e tjera publike, të cilat merren në Republikën e Shqipërisë lidhur me përfundimin dhe zbatimin e kontratave të përmendura në nenin 2, paragrafi 1.

#### Neni 4

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i lejon pasagjerët dhe furnizuesit të zgjedhin lirisht ndërmarrjet transportuese për transportimin e

personave dhe të mallrave në rrugë detare, tokësore dhe ajrore që rezultojnë nga dhënia e huave dhe e shumave të financimit, nuk merr asnjë masë e cila përjashton ose vështirëson pjesëmarrjen me të drejta të barabarta të ndërmarrjeve transportuese me qendër në Republikën Federale të Gjermanisë, dhe nxjerr në rastet e duhura lejet e nevojshme për pjesëmarrjen e këtyre ndërmarrjeve transportuese.

#### Neni 5

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën, kur Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i njofton Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, se janë përmbushur kushtet brendashtetërore për hyrjen në fuqi. Përcaktuese është dita e marrjes së njoftimit.

Bërë në Tiranë, \_\_\_\_\_, në dy origjinale, secila në gjuhën shqipe dhe gjermane, duke pasur të dyja tekstet fuqi të barabartë.

### LIGJ

Nr. 88/2015

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES  
NDËRMJET KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË  
SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË  
REPUBLIKËS FEDERALE TË  
GJERMANISË PËR BASHKËPUNIMIN  
FINANCIAR 2011, PËR PROJEKTIN  
“EFICIENCA ENERGJETIKE -  
PROGRAMI PËR SEKTORIN E  
TRANSMETIMIT TË ENERGJISË  
ELEKTRIKE”**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

#### KUVENDI

#### I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

#### VENDOSI:

#### Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar 2011, për projektin “Eficienca energjetike-programi për sektorin e transmetimit të energjisë elektrike”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji.



Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 23.7.2015

**Shpallur me dekretin nr. 9200, datë 30.7.2015 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani**

### MARRËVESHJE

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË MBI BASHKËPUNIMIN FINANCIAR 2011 PËR PROJEKTIN “EFICIENCA ENERGETIKE – PROGRAMI PËR SEKTORIN E TRANSMETIMIT TË ENERGISË ELEKTRIKE”

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë, në frymën e marrëdhënieve miqësore ekzistuese ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë;

duke u nisur nga dëshira për t'i forcuar dhe thelluar këto marrëdhënie miqësore nëpërmjet Bashkëpunimit Financiar si partnerë; të ndërjegjshëm se ruajtja e këtyre marrëdhënieve përbën bazën e kësaj marrëveshjeje;

me qëllim për të kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë;

duke iu referuar premtimit të ambasadës së Republikës Federale të Gjermanisë (nota verbale nr. 164/2011, e datës 21 shtator 2011),

u morën vesh si vijon:

Neni 1

1. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë ose huamarrësve të tjerë, të cilët do të zgjidhen bashkërisht nga të dyja Qeveritë, të marrin për projektin “Eficiencia energjetike – Programi për sektorin e transmetimit të energjisë elektrike” një hua me kushte të favorshme nga Kreditanstalt für Wiederaufbau (KfW), e cila akordohet në kuadër të bashkëpunimit publik zhvillimor, me vlefë prej deri në 40.000.000 eurosh (me fjalë: dyzet milionë euro), kur nga shqyrtimi përkatës ka rezultuar se projekti vlen për t'u mbështetur në kuadër të politikës zhvillimore dhe kur Republika e

Shqipërisë vazhdon të jetë e besueshme lidhur me kreditë dhe kur Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë jep garanci shtetërore, në rast se ai vetë nuk është huamarrës. Projekti në fjalë nuk mund të zëvendësohet me projekte të tjera.

2. Në rast se Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë, në një kohë të mëvonshme, i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të marrë nga Kreditanstalt für Wiederaufbau hua ose shumë të tjera financimi për përgatitjen e projektit të përmendur në paragrafin 1 ose shumë të tjera financimi për masa të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit të përmendur në paragrafin 1, atëherë gjen zbatim kjo marrëveshje.

3. Shumat e financimit për masa përgatitore dhe shoqëruese, sipas paragrafit 2, do të kthehen në hua, në rast se ato nuk përdoren për masa të tilla.

Neni 2

1. Përdorimi i shumës së përmendur në nenin 1, kushtet me të cilat vihet në dispozicion ajo, si dhe procedura e dhënies së porosisë përcaktohen në kontratat që do të përfundohen midis Kreditanstalt für Wiederaufbau dhe marrësve të huave dhe të shumave të financimit, të cilat u nënshtrohen dispozitave ligjore që janë në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë.

2. Premtimi i shumës së përmendur në nenin 1 do të zhvleftësohet, në rast se kontratat përkatëse të huadhënies nuk përfundohen brenda një afati prej tetë vjetësh pas vitit të premtimit. Për shumën e përmendur në nenin 1, ky afat mbaron në datën 31 dhjetor 2016.

3. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ai vetë nuk është huamarrës, do të garantojë ndaj Kreditanstalt für Wiederaufbau të gjitha pagesat me euro për shlyerjen e borxheve të huamarrësve, në bazë të kontratave, të cilat do të përfundohen sipas paragrafit 1.

4. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ai vetë nuk është marrësi i shumave të financimit, do të garantojë ndaj Kreditanstalt für Wiederaufbau pretendimet eventuale lidhur me shlyerjen, që mund të lindin në bazë të kontratave për financim, të cilat do të përfundohen sipas paragrafit 1.



## Neni 3

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e liron Kreditanstalt für Wiederaufbau nga të gjitha taksat dhe tatimet e tjera publike, të cilat merren në Republikën e Shqipërisë lidhur me përfundimin dhe zbatimin e kontratave të përmendura në nenin 2, paragrafi 1.

## Neni 4

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i lejon pasagjerët dhe furnizuesit të zgjedhin lirisht ndërmarrjet transportuese për transportimin e personave dhe të mallrave në rrugë detare, tokësore dhe ajrore që rezultojnë nga dhënia e huave dhe e shumave të financimit, nuk merr asnjë masë e cila përjashton ose vështirëson pjesëmarrjen me të drejta të barabarta të ndërmarrjeve transportuese me qendër në Republikën Federale të Gjermanisë, dhe nxjerr në rastet e duhura lejet e nevojshme për pjesëmarrjen e këtyre ndërmarrjeve transportuese.

## Neni 5

1. Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën, kur Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i njofton Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, se janë përbushur kushtet brendashtetërore për hyrjen e saj në fuqi. Përcaktuese është dita e marrjes së njoftimit.

2. Regjistrimi i kësaj marrëveshjeje te sekretariati i Kombeve të Bashkuara, sipas nenit 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara, do të iniciohet menjëherë pas hyrjes së saj në fuqi nga Republika Federale e Gjermanisë. Pala tjetër kontraktuese do të njoftohet për regjistrimin e kryer, duke u shënuar numrin e regjistrimit të Kombeve të Bashkuara, sapo ky të jetë i konfirmuar nga sekretariati i Kombeve të Bashkuara.

Bërë në Tiranë, \_\_\_\_\_, në dy origjinale, secila në gjuhën shqipe dhe gjermane, duke pasur të dyja tekstet fuqi të barabartë.

## LIGJ

Nr. 89/2015

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES  
NDËRMJET KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË  
SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË  
REPUBLIKËS FEDERALE TË  
GJERMANISË PËR BASHKËPUNIMIN  
FINANCIAR 2010, PËR PROJEKTIN  
“EFICIENCA ENERGJETIKE PËRMES  
SEKTORIT BANKAR”**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar 2010, për projektin “Eficienca energjetike përmes sektorit bankar”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 23.7.2015

**Shpallur me dekretin nr. 9201, datë 30.7.2015 të  
Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar  
Nishani**

## MARRËVESHJE

**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE  
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE  
QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË  
GJERMANISË MBI BASHKËPUNIMIN  
FINANCIAR 2010 PËR PROJEKTIN  
“EFICIENCA ENERGJETIKE PËRMES  
SEKTORIT BANKAR”**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë,



*në frymën e marrëdhënieve ekzistuese miqësore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë;*

*duke u nisur nga dëshira për t'i forcuar dhe thëlluar këto marrëdhënie miqësore nëpërmjet Bashkëpunimit Financiar si partnerë;*

*të ndërgjegjshme se ruajtja e këtyre marrëdhënieve përbën bazën e kësaj marrëveshjeje;*

*me qëllim për të kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë;*

*duke iu referuar bisedimeve ndërqeveritare të datës 18 maj 2010,*

*u morën vesh si vijon:*

#### Neni 1

1. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë ua jep mundësinë Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë ose huamarrësve të tjerë, që do të zgjidhen bashkërisht nga të dyja Qeveritë, të marrin për projektin “Eficienca energjetike përmes sektorit bankar” një hua me kushte të favorshme nga Kreditanstalt für Wiederaufbau (KfW), e cila akordohet në kuadër të bashkëpunimit publik zhvillimor, me vlefte prej deri në 12.000.000 eurosh (me fjalë: dymbëdhjetë milionë euro), kur nga shqyrtimi përkatës ka rezultuar se projekti vlen për t'u mbështetur në kuadër të politikës zhvillimore dhe kur Shqipëria vazhdon të jetë e besueshme lidhur me kreditë. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë zotohet të mos e pengojë projektin dhe të përkrahë Qeverinë e Republikës Federale të Gjermanisë, kundrejt marrësit, lidhur me pretendimet eventuale për kthimin e huas për shkak të përdorimit të saj të padrejtë. Projekti në fjalë nuk mund të zëvendësohet me projekte të tjera.

2. Në rast se Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë, në një kohë të mëvonshme i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të marrë nga Kreditanstalt für Wiederaufbau hua ose shuma të tjera financimi për përgatitjen e projektit të përmendur në paragrafin 1 ose shuma të tjera financimi për masa të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit të përmendur në paragrafin 1, atëherë gjen zbatim kjo marrëveshje.

3. Shumat e financimit për masa përgatitore dhe shoqëruese sipas nenit 1, paragrafi 2 do të kthehen në hua, në rast se ato nuk përdoren për masa të tilla.

#### Neni 2

1. Përdorimi i shumës së përmendur në nenin 1, kushtet me të cilat vihet në dispozicion ajo, si dhe procedura e dhënies së porosisë përcaktohen në kontratat që do të përfundohen midis Kreditanstalt für Wiederaufbau dhe marrësve të huas dhe të shumave të financimit, të cilat u nënshtrohen dispozitave ligjore që janë në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë.

2. Premtimi i shumës së përmendur në nenin 1 do të zhvleftësohet, në rast se kontratat përkatëse të huadhënies dhe të financimit nuk përfundohen brenda një afati prej tetë vjetësh pas vitit të premtimeve. Për shumën e përmendur në nenin 1, ky afat mbaron në datën 31 dhjetor 2018.

#### Neni 3

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e liron Kreditanstalt für Wiederaufbau nga të gjitha taksat dhe tatimet e tjera publike, të cilat merren në Republikën e Shqipërisë lidhur me përfundimin dhe zbatimin e kontratave të përmendura në nenin 2 paragraf 1.

#### Neni 4

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i lejon pasagjerët dhe furnizuesit të zgjedhin lirisht ndërmarrjet transportuese për transportimin e personave dhe të mallrave në rrugë detare, tokësore dhe ajrore që rezultojnë nga dhënia e huas dhe e shumave të financimit, nuk merr asnjë masë e cila përjashton ose vështirëson pjesëmarrjen me të drejta të barabarta të ndërmarrjeve transportuese me qendër në Republikën Federale të Gjermanisë, dhe nxjerr në rastet e duhura lejet e nevojshme për pjesëmarrjen e këtyre ndërmarrjeve transportuese.

#### Neni 5

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën, kur Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i njofton Qeverinë e Republikës Federale të Gjermanisë, se janë përmbushur kushtet brendashtetërore për hyrjen në fuqi. Përcaktuese është dita e marrjes së njoftimit.

Bërë në Tiranë, \_\_\_\_\_, në dy origjinale, secila në gjuhën shqipe dhe gjermane, duke pasur të dyja tekstet fuqi të barabartë.



**LIGJ**  
**Nr. 90/2015**

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.92/2014, “PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHITUAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, 83, pika 1, dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në nenin 77, “Rimbursimi i TVSH-së”, pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së tatimpaguesit dhe brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së tatimpaguesve eksportues, administrata tatimore kryen procedurën e rimbursimit, siç përcaktohet për këtë qëllim në ligjin “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë.

Administrata tatimore, para se të procedojë një kërkesë për rimbursim të TVSH-së për një person të tatueshëm, ka të drejtë ta detyrojë atë person të provojë që qëllimi i veprimtarisë ekonomike është realizimi i transaksioneve të tatueshme, që i japin të drejtën e zbritjes së TVSH-së.”

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 23.7.2015

**Shpallur me dekretin nr. 9202, datë 30.7.2015 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani**

**LIGJ**  
**Nr. 91/2015**

**PËR NJË SHITESË DHE NDRYSHIM NË LIGJIN NR.9920, DATË 19.5.2008, “PËR PROCEDURAT TATIMORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, 83, pika 1, dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në ligjin nr.9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen shtesa dhe ndryshimi si më poshtë:

Në nenin 16, “Struktura e administratës tatimore qendrore”, pika 3, pas shkronjës “ë” shtohet shkronja “P” me këtë përmbajtje: “f) rimbursimi tatimor.”.

Neni 2

Në nenin 75/1, “Rimbursimi i TVSH-së dhe kompensimi i detyrimeve tatimore”, pika 1 riformulohet si më poshtë:

“1. Personat e tatueshëm, të regjistruar për TVSH-në, që rezultojnë me tepriçë kreditore, kanë të drejtë të paraqesin kërkesën për rimbursimin e TVSH-së së paguar tepër pranë Drejtorisë së Rimbursimit të TVSH-së në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve. Kjo kërkesë paraqitet sipas formularit të miraturar “Kërkesë për rimbursimin e TVSH-së”.

Brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së tatimpaguesit dhe brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së tatimpaguesve eksportues, Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, në bashkëpunim me drejtorinë rajonale tatimore, ku është i regjistruar tatimpaguesi, verifikojnë situatën tatimore të tatimpaguesit dhe miratojnë tepriçën kreditore si të rimbursueshme. Kur është e nevojshme, administrata tatimore ushtron kontroll bazuar në analizën e riskut.





Pagesa e tepicës kreditore të rimbursueshme kryhet brenda pesë ditëve, nëpërmjet sistemit të thesarit, në bazë të rregullave të përcaktuara në udhëzimin e Ministrit të Financave. Në rast të kundërt, personit të tatueshëm i lind e drejta e mospagesës së detyrimeve të tjera tatimore në masën e TVSH-së së pretenduar për rimbursim.”

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 23.7.2015

**Shpallur me dekretin nr. 9203, datë 30.7.2015 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani**

**LIGJ  
Nr. 92/2015**

**PËR DISA SHTESA NË LIGJIN  
NR.22/2014 “PËR DHËNIE AMNISTIE”**

Në mbështetje të neneve 81, pikat 1 e 2, shkronja “ë”, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

**KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Neni 1

Në nenin 3, pas shkronjës “ç” shtohet shkronja “d” me këtë përmbajtje:

“d) personat e dënuar me burgim për veprën penale të ndërtimit të paligjshëm, parashikuar nga neni 199/a, paragrafi i dytë, i Kodit Penal, kur vepra penale është kryer jo më vonë se data 10 prill 2014.”

Neni 2

Në nenin 5 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Amnistohen nga ndjekja penale të gjithë personat, të cilët akuzohen se kanë kryer veprën penale të ndërtimit të paligjshëm, parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal, në rastet kur vepra penale në fjalë është kryer jo më vonë se data 10 prill 2014.”

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 23.7.2015

**Shpallur me dekretin nr. 9204, datë 30.7.2015 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani**

**VENDIM  
Nr. 82/2015**

**PËR CAKTIMIN E MASËS SË  
SHPËRBLIMIT MUJOR FIKS TË  
ANËTARIT TË KËSHILLIT DREJTUES  
TË RADIOTELEVISIONIT SHQIPTAR**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës dhe të nenit 98, pika 1, të ligjit nr.97/2013, “Për mediat audiovizive në Republike e Shqipërisë”, me propozimin e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik,

**KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

I. Masa e shpërblimit mujor fikse të anëtarit të Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar është 30 për qind e masës së përcaktuar në pikën D/7 të lidhjes nr. 1 të ligjit nr.9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar.

II. Efektet e këtij vendimi shtrihen nga konstituimi i Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Miraturar në datën 23.7.2015

**KRYETARI  
Ilir Meta**

**VENDIM****Nr. 697, datë 6.8.2015****PËR DHËNIEN E NDIHMËS  
FINANCIARE, NGA QEVERIA  
SHQIPTARE PËR QEVERINË E  
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË, PËR  
LEHTËSIMIN E PASOJAVE TË  
DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA  
PËRMBYTJET NË GUSHT 2015, NË  
TETOVË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe nenit 13, të ligjit nr. 160/2014, "Për buxhetin e vitit 2015", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Dhënie e ndihmës financiare, nga qeveria shqiptare, për qeverinë e Republikës së Maqedonisë, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) euro, për lehtësimin e pasojave të dëmeve të shkaktuara nga përmbytjet në gusht 2015, në Tetovë.

2. Ministrisë së Punëve të Jashtme, në buxhetin e miratuar për vitin 2015, në programin buxhetor 01120 "Mbështetje diplomatike jashtë shtetit", shpenzime korrente, t'i shtohet kundërvlera në lekë e fondit prej 50 000 (pesëdhjetë mijë) eurosh, për t'u përdorur si ndihmë financaire për lehtësimin e pasojave të dëmeve të shkaktuara nga përmbytjet e muajit gusht 2015, në Tetovë.

3. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2015.

4. Ngarkohen Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2015

Adresa  
Bulevardi “Gjergj Fishta”,  
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,  
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 196 lekë